

RËNDËSIA E SHOQËRISW CIVILE

Shoqëria civile mund të konsiderohet një arenë e veprimit vullnetar kolektiv rreth interesave, qëllimeve dhe vlerave të përbashkëta në shoqëri. Në këtë aspekt shoqëria civile mund të shihet si bazë, mbi të cilën ndërtohet kapitali social. Organizatat e Shoqërisë civile nuk veprojnë në vakuum. Ato janë të lidhura ngushtë me kushtet shoqërore, politike, ekonomike dhe demografike. Si rrjedhojë Shoqëria Civile mund të fuqizojë zhvillimin shoqëror, duke i rritur mundësitë dhe qasjen në burime si psh përmes krijimit të mekanizmave për të qenë zë i njerëzve të rrezikuar apo të cenueshëm gjatë debateve për politikën publike. Njëkohësisht, organizatat shoqërisë civile i kontribuojnë zhvillimit njerëzor përmes pjesëmarrjes dhe partneritetit, duke inkurajuar dialogun për qeverisjen dhe prosperitetin ekonomik

SHOQËRIA CIVILE NË SHIFRA

- **70%** e OJQ-ve i implementojnë projektet e tyre në rrethet (lokalitetet) e tyre dhe 30% kanë një veprimtari kombëtare
- **89%** e OJQ-ve janë të përqendruara në Tiranë dhe qytetet kryesore ndërsa **11%** zhvillojnë aktivitetin në zonat rurale dhe periferike.
- **43%** e organizatave të shoqërisë civile janë përqendruar në fushën e të drejtave të njeriut
- Rreth **43%** e OJQ-ve merren me promovimin e demokracisë, zhvillimin ekonomik dhe çështjet e mjedisit.
- **12%** e OJQ-ve promovojnë zhvillimin ekonomik.
- **34%** aktivitetit të shoqërisë civile fokusohet në zvogëlimin e varfërisë dhe zhvillimin rural, ndërsa pjesa tjetër merret me çështjet e zhvillimit ekonomik në përgjithësi.

Burimi: "Euclid 2009"



"Fuqizimi i Shoqërisë Civile në Zonat Rurale dhe Periferike"

Drejt një qeverisje të mirë dhe zhvillim



Projekt kombëtar

LEZHE - ELBASAN - BERAT - GJIROKASTER

PËRSE KY PROJEKT ?

Pjesëmarrja qytetare dhe mbi të gjitha roli më aktiv i shoqërisë civile, vazhdon të jetë problematike, në veçanti në zonat rurale e periferike. IDM në bashkëpunim me PNUD-in ka nisur implementimin e projektit “Fuqizimi i Shoqërisë Civile në Zonat Rurale dhe Periferike”. Projekti fillimisht do të bëjë një vlerësim të aktorëve kryesorë të shoqërisë civile në Qarkun e Lezhës, Elbasanit, Gjirokastrës e Beratit. Përgatitja e kapaciteteve të organizatave vendore të shoqërisë civile dhe zhvillimi i prioriteteve në rajonet që ato operojnë, përbëjnë komponentët kryesorë të këtij projekti. Një fokus i veçantë do t’i kushtohet forcimit të principeve themelore të shoqërisë civile rurale si transparencës, përgjegjshmërisë, gjithpërfshirjes etj.



TARGETI

- Organizata të Shoqërisë Civile
- Institucionet e Qeverisjes Lokale
- Komunitetet Lokale
- Komuniteti i Biznesit
- Media

QËLLIMI I PROJEKTIT

- Ndërtimi i kapaciteteve të qëndrueshme për shoqërinë civile rurale si aktor kyç në zhvillimin e prioriteteve të komuniteteve lokale nëpërmjet aksioneve konkrete.
- Sensibilizimi dhe advokimi me vendim-marrësit në nivel kombëtar/lokal, në dobi të zhvillimit të alternativave në krijimin e partneriteteve komunitet-biznes-qeverisje.

PERCEPTIME MBI SHOQËRINË CIVILE

Në një sondazh që Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim zhvilloi në Qarkun Lezhë, Elbasan, Berat dhe Gjirokastrë me anëtarë të organizatave jo-qeveritare, u zbuluan fakte konkrete mbi aktivitetin, problemet dhe sfidat e shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike.

- **22%** mendojnë se shoqëria civile është aktive ose shumë aktive.
- **78%** e vlerësojnë atë pak ose aspak aktive
- **22%** e tyre e vlerësojnë pozitivisht ndikimin e aktivitetit të shoqërisë civile
- **71%** e tyre besojnë se shoqëria civile në zonat rurale e periferike adreson vetëm pjesërisht nevojat e komunitetit të këtyre zonave.
- **24%** mendojnë se aktiviteti i shoqërisë civile, është i shkëputur nga realiteti.

NEVOJAT AKTUALE

- Vende të reja pune;
- Projekte për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë;
- Zhvillimi i infrastrukturës së zonës (p.sh për rruge, sisteme për ujitjen e tokave etj);
- Ndërgjegjësimin e komunitetit, inkurajimin e vullnetarizmit dhe punës në komunitet;
- Pjesëmarrja më e gjerë e grave në jetën komunitare, politikëbërje etj;
- Rritjen e bashkëpunimi ndër-insitucional;
- Mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve;
- Çështjet sociale dhe shërbimi shëndetësor e arsimor për njerëzit me aftësi të kufizuara



ARRITJET KRYESORE

- Advokimi dhe lobimi në mbështetje të grupeve të caktuara interesi apo për zonën në tërësi
- Respektimi i të drejtave të grave dhe fëmijëve (përfshi kategori të veçanta të tyre si psh gratë e dhunuara, fëmijët me probleme zhvillimi etj);
- Ruajtja dhe promovimi i kulturës, traditës dhe zakoneve të zonave ku punohet;
- Mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i turizmit (kulturor dhe mjedisor);
- Promovimi i grupeve të ndryshme profesionale (psh fermerësve, gazetarëve lokalë etj.

PROBLEMATIKA E SHOQËRISË CIVILE NË SHQIPËRI

- Vendimet në OShC merren nga drejtues të emëruar (**27.6%**), bord i emëruar (**27.6%**) ose bord i zgjedhur (**19.5%**).
- Tek vetëm 8% e OShC vendimet merren nga anëtarët (**6.9%**) ose stafi (**1.1%**).
- **42.1%** of OShC refuzojnë të japin një burim public për informacionin financiar të tyre.
- Mbi **75%** e OShC nuk e mohojnë ekzistencën e rasteve korruptive tek ShC.
- Rastet e korrupsionit tek ShC janë të shpeshta (**26.7%**) ose shumë të shpeshta (**11.6%**) sipas përfaqësuesve të OShC.
- Rastet e korrupsionit kanë të bëjnë kryesisht me keqmenaxhimin e fondeve (**48.2%**).